

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR PËRGJEGJËSITË E ZGJERUARA TË SUBJEKTEVE PRODHUESE TË PRODUKTEVE QË GJENEROJNË MBETJE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Menaxhimi i integruar i mbetjeve bazohet në zbatimin e hierarkisë së mbetjeve, që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Një ndër parimet kryesore të menaxhimit të mbetjeve është parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (në vijim, PZP), që është përcaktuar si i tillë dhe në Dokumentin e Politikave Strategjike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për Periudhën 2020-2035, në përputhje me parashikimet e direktivës kuadër të mbetjeve DKM (2008/98/EC, të ndryshuar).

Në kuadër të hapjes së negociatave dhe të takimit dypalësh “*screening*” për kapitullin 27, “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit janë ndër parimet themelore që duhen transpozuar në kontekstin e menaxhimit të integruar të mbetjeve, për faktin se zbatimi i sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje (PZP) ndikon në nxitjen e ndarjes së diferencuar të mbetjeve në burim dhe riciklimin e tyre për rrymat e mbetjeve, për të cilat zbatohet, duke ndikuar në një masë të konsiderueshme në uljen e sasisë së mbetjeve që depozitohen në pikën fundore të menaxhimit të mbetjeve.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet transpozimi i pjesshëm i DKM-së, konkretisht i neneve 8 dhe 8(a) të kësaj direktive, që lidhen me përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, që lidhen me amendimin e vitit 2018 të direktivës.

Në këtë kontekst, sqarojmë se, megjithëse ligji nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, është amenduar me ligjin nr.70/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011”, të ndryshuar, ky amendim lidhet me forcimin e kundërvajtjeve dhe rritjen e masës së gjobave, të përcaktuara në ligjin ekzistues.

Projektligji “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje” ka si qëllim të krijojë sistemin e përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetje (në vijim,

PZP) dhe të sigurojë që çdo person fizik ose juridik që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale, produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit në funksion të rritjes së ripërdorimit, parandalimit, riciklimit dhe rikuperimeve të këtyre produkteve.

PZP-ja është një detyrim për prodhuesit, për kompanitë, të cilat vendosin në tregun e brendshëm të vendit produkte, të cilat pasi përdoren, gjenerojnë mbetje që i përkasin njëres prej rrymave të mbetjeve të përcaktuara në projektligj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Këto kompani, sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian për mbetjet, kanë detyrime dhe përgjegjësi shtesë për të menaxhuar mbetjet që gjenerohen nga produktet e tyre. Detyrimet e tyre rregullohen në një legjislacion të posaçëm në nivelin e Bashkimit Evropian.

Ndër detyrimet kryesore të prodhuesit janë të financojnë dhe të krijojnë një sistem për grumbullimin, transportimin, riciklimin ose një mënyrë tjetër të trajtimit të mbetjeve të krijuara nga produktet e tyre që ata vendosin në treg në Shqipëri dhe të përmbushin objektivat (*targets*) për mbledhjen, riciklimin dhe trajtimin e tyre, siç përcaktohet nga legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe/ose ai kombëtar.

Fusha e zbatimit të ligjit janë të gjitha subjektet prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje, që zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë aktivitete ekonomike, të cilat lidhen me qëllimin e ligjit, nën sistemin e PZP-së dhe hedhin në treg produkte, konsumimi i të cilave krijon mbetje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.

Ky ligj do të zbatohet për rrymat specifike të mbetjeve dhe që janë pjesë e sistemit të PZP-së, si më poshtë:

- ambalazhet dhe mbetjet e tyre;
- bateritë dhe akumulatorët;
- automjetet në fund të jetës; dhe
- mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike,

sipas parashikimeve të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ligji do të zbatohet edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore në përmbushje të funksioneve të tyre, me qëllim arritjen e objektivave kombëtarë në fushën e mbetjeve, të përcaktuara në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, miratuar me

vendimin nr.418, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe për vetëqeverisjen vendore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në katërmujorin e tretë të programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për vitin 2024 dhe është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe programin e përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për nismat ligjore e nënligjore, që duhen ndërmarrë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për mjedisin dhe përafrimin e EU “*acquis*” për kapitullin 27, “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”.

Projektligji është pjesë e PKIE 2023-2025 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i këtij projektligji është vlerësuar i domosdoshëm për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të përgjegjësi të zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje, që do të thotë, zbatimi i parimit “ndotësi paguan”, si dhe kontributin për uljen e sasisë së mbetjeve, rritjen e shkallës së riciklimit dhe zbatimin e hierarkisë së mbetjeve.

Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesve (PZP) është konsideruar si një instrument madhor në mbështetje të implementimit të hierarkisë së mbetjeve në Evropë dhe rrjedhimisht për rritjen nëpërmjet prioritetit të parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit.

Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për periudhën 2020-2035 (PKMIM) përcakton drejtimit strategjike dhe masat e nevojshme për të plotësuar detyrimet e vendit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian nëpërmjet përputhshmërisë me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në kapitullin 27 për mjedisin. Arritja e këtyre objektivave ka një kosto të konsiderueshme financiare dhe vendosja e sistemeve efektive të PZP-së është e rëndësishme në këtë aspekt.

Sipas PKMIM 2020-2035, objektivat kombëtarë pritet që të mbulohen të paktën pjesërisht nga futja e një sistemi PZP. Në dokument prezantohet se “objektivat e ripërdorimit dhe reduktimit të mbetjeve nëpërmjet riciklimit do të arrihen vetëm

nëse futet sistemi i PZP-së të subjekteve prodhuese për produktet që gjenerojnë mbetjes”. Implementimi i sistemit të PZP-së përmban masa të përfshira/lidhura në PKMIM 2020-2035, sipas objektivit strategjik nr.1, objektiva specifike nr.1 dhe 2, dhe objektivi strategjik nr.3, objektivi specifik nr.1.

Zbatimi i përgjegjësisë së prodhuesit mundëson që prodhuesit/importuesit të financojnë shërbimet që ofrojnë njësitë e qeverisjes vendore dhe të cilat përdoren për të mbështetur përmbushjen e detyrimeve të prodhuesve. Sa më shumë material riciklohet sipas skemave të përgjegjësisë së prodhuesit, aq më e ulët është barra financiare që i mbetet sektorit publik dhe rrjedhimisht taksapaguesve. Ngritja e sistemeve efektive të PZP-së do të kontribuojë në rritjen e jetëgjatësisë së landifilleve në Shqipëri, duke ulur kostot për njësitë e qeverisjes vendore në trajtimin e mbetjeve dhe përmbushjen e objektivave të vendosur dhe, si rrjedhojë, tatimpaguesit në tërësi, duke i kanalizuar ato nën parimin “ndotësi paguan”.

Ngritja e sistemit të PZP-së kërkon angazhimin e ndërgjegjësimin e të gjitha subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje, objekt i këtij ligji.

Efektet e pritshme, me gjithë sfidat e fillimit, priten të jenë shumë të favorshme për mjedisin dhe mbrojtjen e tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në bazë të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të ndryshuar, i cili autorizon nxjerrjen e një ligji të posaçëm, që parashikon rregulla për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit. Gjithashtu, projektligji synon përafrimin e pjesshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian: me direktivën kuadër të mbetjeve (DKM) 2008/98/EC të 19 nëntorit 2008, të ndryshuar përkatësisht në vitin 2018, nëpërmjet shtimit të nenit 8(a), “Kërkesat minimale të përgjithshme për skemat për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit” të saj. Për rrjedhojë, projektligji është në harmonizim të plotë me legjislacionin në fuqi vendas e atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji ka karakter teknik dhe synon përafrimin e pjesshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian: me direktivën kuadër të mbetjeve (DKM) 2008/98/EC të 19 nëntorit 2008, të ndryshuar, konkretisht me nenet 8 dhe 8(a)

ndryshuar në vitin 2018, ndryshim, i cili lidhet ngushtësisht me përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, nëpërmjet shtimit të nenit 8(a), “Kërkesat minimale të përgjithshme për skemat për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit” të saj, që lidhen më përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit. Këto dispozita synohen të transpozohen nëpërmjet këtij projektligji, si një kontribut për rritjen graduale të shkallës së përafrimit me EU *acquis* të fushës së mbetjeve.

Nenet e tjera të direktivës kuadër të mbetjeve aktualisht janë të përafruara në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

Direktiva kuadër e mbetjeve, megjithëse është vlerësuar si plotësisht e përafruar me ligjin nr.10463/2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ka pësuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme, përkatësisht në vitet 2014, 2015, 2017, 2018 dhe 2023.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kreu I, “Dispozita të përgjithshme”, përfshin nenet që lidhen me qëllimin e ligjit, objektin e tij, përkufizimet dhe fushën e zbatimit, duke u shprehur se dispozitat e këtij projektligji do të zbatohen për katër rryma specifike mbetjesh: ambalazhet dhe mbetjet e tyre; bateritë dhe akumulatorët; automjetet në fund të jetës dhe mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Ky ligj do zbatohet për të gjitha subjektet prodhuese, që zhvillojnë në Republikën e Shqipërisë aktivitete ekonomike, që lidhen me qëllimin e ligjit, nën sistemin e PZP-së dhe hedhin për herë të parë në treg produkte, përdorimi i të cilave krijon mbetje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat specifike të mbetjeve.

Kreu II - Sistemi i përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese trajton detyrimet e subjekteve prodhues, sistemin e PZP, detyrimin për informim dhe detyrimin për regjistrim dhe kontratën me SHPZP për secilën rrymë mbetjesh të përcaktuara në këtë projektligj dhe informacionin për konsumatorin.

Në nenin 5 parashikohen detyrimet e çdo subjekti prodhues, që zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon mbi baza profesionale produkte që gjenerojnë mbetje pas përdorimit dhe përfshihet në sistemin e përgjegjësive të zgjeruar të subjekteve prodhuese.

Në nenin 6 parashikohen detyrimet e subjektit prodhues, që krijon sistemin e përgjegjësive të zgjeruar të subjekteve prodhuese nëpërmjet vendosjes për herë

të parë në treg të produkteve, pjesë e sistemit PZP. Konkretisht parashikohet që subjekti prodhues zbaton detyrimet e tij sipas mënyrave të mëposhtme:

- a) Organizon vetë sistemin e marrjes mbrapsht, të grumbullimit e të trajtimit të mbetjeve;
- b) Së bashku me subjektet prodhuese të tjera, organizojnë një sistem kolektiv të organizuar të marrjes mbrapsht, të grumbullimit e të përpunimit të mbetjeve nëpërmjet një kompanie të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie; ose
- c) Të krijojnë SHPZP për marrjen mbrapsht, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve, në përputhje me këtë ligj.

Gjithashtu, subjektet prodhuese, pjesë e sistemit PZP, përgjigjen financiarisht dhe organizativisht për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë pikë, sipas pjesës takuese përkatëse, përfshirë dhe dhënien prej tij të kontributit financiar e detyrimin për informim të konsumatorit.

Në këtë kre parashikohet edhe detyrimi i çdo subjekti prodhues si pjesë e sistemit PZM për të lidhur kontratë me SHPZP, në rast se nuk e organizon vetë sistemin e marrjes mbrapsht, grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve, po ai do të regjistrohet në SHPZP sipas rrymës përkatëse për të cilën është subjekt i detyrimeve të PZP-së; si dhe detyrimi për raportim tremujor pranë SHPZP-së dhe AKM-së, për sasinë e produkteve PZP të vendosura në treg brenda datës 15 (pesëmbëdhjetë) të muajit pasardhës.

Kreu III, Përgjegjësitë e SHPZP-së, konsiston në parashikimet që lidhen me detyrimet e SHPZP-së, e cila merr përsipër detyrimet PZP të prodhuesve që përfaqësojnë të paktën 25 për qind dhe jo më shumë se 70 për qind të sasive të produkteve PZP të hedhura në treg për çdo vit të ushtrimit të veprimtarisë; pajisjen me autorizim nga ministri përgjegjës për mjedisin, zgjidhjen e kontratës së SHPZP me subjektin prodhues, detyrimin e kontributit financiar për SHPZP, përmbushjen e objektivave kombëtarë për mbetjet, mospërmbushjen e detyrimeve, raportimin pranë SHPZP-së dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Kreu IV parashikon institucionet përgjegjëse për zbatim e monitorim të ligjit, ku ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij; koordinimin ndërinstucional lidhur me zbatimin dhe mirëfunksionimin e sistemit PZP; pajisjen me autorizim për SHPZP-në, për ushtrimin e veprimtarive lidhur me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të krijuara nga produktet dhe të rrymave specifike të mbetjeve për rikuperimin, ripërdorimin ose riciklimin e tyre; përgatitjen dhe propozimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji; informimin e publikut të gjerë lidhur me këtë

ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për zbatimin e sistemit PZP, kur konsiderohet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të njeriut ose të mjedisit.

Ndërsa institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e sistemit të përgjegjësive të zgjeruara të subjekteve prodhuese janë:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim, AKM), si institucioni përgjegjës i kontrollit në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhur me produktet PZP.
2. autoritetet e mbikëqyrjes së tregut; dhe
3. autoriteti doganor, që është përgjegjës për kontrollin e produkteve, pjesë e sistemit të PZP-së në pikat doganore të hyrjes e të daljes.

Kreu V parashikon rregullat për regjistrimin e raportimin e produkteve të prodhuesve PZP dhe SHPZP, dispozitat që lidhen me procedurën e regjistrimit të produkteve të prodhuesve PZP dhe SHPZP dhe raportimin vjetor nëpërmjet aplikimit në portalin unik qeveritar *e-Albania*. Agjencia Kombëtare e Mjedisit do të krijojë një bazë të dhënash në regjistrin elektronik për subjektet prodhuese për çdo produkt PZP dhe të SHPZP-ve të autorizuara, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore.

Kreu VI parashikon kundërvajtjet administrative, masat e gjobave për mospërmbushje të detyrimeve të këtij ligji, përmban nenet për kundërvajtjet administrative, procedurën e kundërvajtjeve administrative, si dhe pezullimin e anulimin e autorizimit. Gjoha e dhënë pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, përbën titull ekzekutiv.

Kreu VII parashikon dispozita kalimtare e të fundit dhe përmban nenet për nxjerrjen e akteve nënligjore, dispozitat kalimtare dhe hyrjen në fuqi.

Projektligji u publikua në faqen e konsultimit publik më 25 tetor 2023, konsultim, i cili përfundoi më 7 dhjetor 2023.

Gjatë kësaj periudhe, projektligji pati 1373 shikime dhe 6 komente të paraqitura. Ndërkohë, Shoqata e Prodhuësve të Shqipërisë kërkoi pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit zgjatjen e periudhës së konsultimit për të mundësuar koordinimin e brendshëm. Sqarojmë se, pavarësisht zgjatjes së periudhës nga ana jonë, nuk u paraqitën komente.

Për të gjitha konsultimet shteruese me shoqatat e biznesit janë zhvilluar disa takime konsultative të Shtëpia e Biznesit, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, në varësi të ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen

dhe Klimën e Biznesit. Projektligji është prezantuar dhe diskutuar me shoqatat e biznesit dhe në takimin e parë të Komisionit Këshillimor për Politikën e Tranzicionit të Gjelbër, të mbajtur më 18 prill 2024.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit janë:

- ministria përgjegjëse për mjedisin;
- institucioni përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin në mjedis;
- agjencia përgjegjëse për ekonominë e mbetjeve;
- institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut;
- institucioni përgjegjës për doganat;
- institucioni përgjegjës për tatimet;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me asistencën teknike dhe juridike me ekspertë kombëtarë e ndërkombëtarë nga projekti SANE 27 II, “Mbështetje për negociatat në mjedis për Shqipërinë”, financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ligji “Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit” sjell detyrime financiare, të cilat, në mënyrë të detajuar, janë analizuar te dokumenti i RIA-s për këtë projektligj.

Kostot fillestare të zbatimit: Krijimi i kornizave ligjore, monitorimi i pajtueshmërisë dhe zbatimi i kësaj politike kërkojnë investime të qeverisë.

Në këtë kuadër, kostoja shtesë për buxhetin e shtetit parashikohet të ketë për shtimin e organikës së administratës, respektivisht me 8 punonjës për të garantuar zbatimin e opsionit 2. Si bazë, për përlogaritjen e koston është marrë paga mesatare bruto për këtë kategori punonjësish që është parashikuar 104,167 lekë. 8 punonjës x 104,167 lekë = 833,333 lekë (kosto për paga për 1 muaj). Kjo vlerë do të shumëzohet me 12 muaj, pra, 833,333 lekë x 12 muaj = 10,000,000 lekë. Pra, kjo kosto vjetore parashikohet të jetë përafërsisht rreth 10 milionë lekë/vit. Kjo kosto shtesë është

tërësisht e papërfillshme në krahasim me kursimet që vijnë për buxhetin dhe taksapaguesit nga zbatimi i opsionit 2, ku një pjesë e konsiderueshme e kostove të trajtimit të mbetjeve do të mbulohen nga prodhuesit dhe ndotësit/gjeneruesit e mbetjeve.

Për tri vitet e para, kostoja prej 10 milionë lekësh në vit do të planifikohet në buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke filluar nga viti 2026 kur është planifikuar të hyjë në fuqi projektligji.

Parimi “ndotësi paguan” lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen te ndotësit dhe konsumatorët përgjegjës për të. Kostot e ndotjes kanë të bëjnë me parandalimin e menaxhimin e mbetjeve në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Zbatimi i PZP-së pritet të sjellë ulje të mbështetjes buxhetore nga qeveria ose të nevojës për to në të ardhmen nga njësitë vendore. Si rrjedhojë, zbatimi i PZP-së do të sillte një kontribut pozitiv në përmbushje të objektivave mjedisore për një jetë më cilësore për qytetarët e vendit, një barrë më të lehtë financiare për tatimpaguesit, sidomos për shtresat në nevojë, që edhe konsumojnë/ndotin edhe më pak.

Në praktikë, PZP-ja nënkupton që prodhuesit marrin përsipër përgjegjësinë për mbledhjen ose marrjen mbrapsht të mallrave të përdorura dhe për klasifikimin e trajtimin për riciklimin e tyre. Kjo përgjegjësi mund të jetë financiare ose organizative gjithashtu. PZP-ja duhet konsideruar si një instrument madhor në mbështetje të implementimit të hierarkisë së mbetjeve dhe, rrjedhimisht, për rritjen nëpërmjet prioritetit të parandalimit, ripërdorimit e riciklimit. Së bashku me instrumente të tjera ekonomike, PZP-ja do të inkurajojë një ndryshim në sjellje të të gjithë aktorëve të përfshirë në zinxhirin e vlerës së produktit: prodhuesit, shitësit, konsumatorët, qytetarët, autoritetet vendore, operatorët e menaxhimit të mbetjeve, publikë dhe privatë, ricikluesit dhe aktorët ekonomiko-socialë.

KËSHILLI I MINISTRAVE